

31.03.2021
Ora 21:09

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shpalljen e moskompetencës së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e përmbytjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :


KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

1.Ilirjana	NANO	Kryetar
2.Arens	ÇELA	Anëtar
3.Dritan	ÇAKA	Anëtar
4.Helga	VUKAJ	Anëtar
5.Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar
• Ilirjan	CELIBASHI	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
• Stafi	KQZ	Y.Merkaj, M.Koja, N.Mezini
Parti	Politike:	PD, LSI, PS, ABEOK

Znj.I.Nano: Mirëmbërëma, siç jeni njoftuar është thirrur mbledhja e Komisionit Rregullator sot në orën 21:00, datë 31 Mars 2021. Në rendin e ditës të mbledhjes së Komisionit Rregullator ka ardhur me propozim të Komisionerit projektvendimi “Për miratimin e përmbytjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”. Pra, kemi vetëm një çështje në rendin e ditës. Më duhet të konfirmoj prezencën e të gjithë anëtarëve në mbledhje. Katër prej të cilëve janë prezent dhe një nga anëtarët e Komisionit Rregullator për arsye objektive nuk është në sallë, por është prezent në mbledhje online, kështu që prania është e plotë. Në mbledhje gjithashtu është i pranishëm

Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.03.2021*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zoti Ilirjan Celibashi dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu janë të pranishëm dhe përfaqësues të subjekteve zgjedhore të atashuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Atëherë, mbledhjen e deklaroj të hapur. Sikundër thashë kemi një çështje në rendin e ditës për procedurë dhe duke u bazuar tek Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit Rregullator, së pari pyes anëtarët e Komisionit nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për diskutim dhe më tej edhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore nëse kanë diçka për të diskutuar jashtë rendit të ditës, kolegë? Po, zoti Çakaj.


Z. M. Çakaj: Po, e Nderuar kisha unë një çështje jashtë rendit të ditës.

Znj. I. Nano: Dakord, është dikush tjetër që dëshiron të diskutojë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës? Atëherë, mendoj që ta nisim me rendin e ditës dhe më pas të vijojmë me një çështje që ka një prej anëtarëve të Komisionit Rregullator jashtë rendit të ditës nëse jemi dakord?

Z. M. Çakaj: Dakord.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Siç e përmenda në fillim të mbledhjes akti që ka ardhur sot për shqyrtim dhe miratim në Komisionin Rregullator lidhet me miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Ditën e djeshme kemi patur një mbledhje tjetër të Komisionit Rregullator dhe pati disa diskutime për procedure, nga zoti Salianji u fillua një diskutim. Zoti Salianji dëshironi ta ringrini këtë çështje apo ta diskutojë Komisioni Rregullator?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.03.2021*

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Po, faleminderit. Jemi njohur me projektaktin e paraqitur nga Komisioneri që iu është paraqitur ju. Është një projektakt i cili ka të bëjë vetëm me një model flete votimi, pavarësisht kundërshtimeve që mund të kemi ne për përmbajtjen e këtij projektakti. Unë i qëndroj kërkesës që kundërshtimet t'i paraqesim në organin i cili është kompetent. Nuk dua të zgjatem, por ju rikujtoj që ju nuk jeni organi kompetent për të diskutuar për përmbajtjen e fletës, në bazë të nenit 12 pika 4, kompetencat e Rregullatorit janë të shënuara qartë ku thuhet që “Komisioni Rregullator është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në funksion të zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhje”. Unë shoh që fleta e votimit nuk është as rregull, as akt normativ dhe nuk ju jeni kompetent. Për sa i përket se ku hyn kompetenca e Komisionerit këtu, ju sqarohet se kompetencë për miratimin e fletës së votimit është KQZ-ja, thotë ligji. Kompetencat e Komisionerit të neni 19, paragrafi 9 thuhet “Komisioneri ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkon asaj me ligje të veçanta si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it. Pra, në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor miratimi i përmbajtjes së fletës së votimit, nuk i njihet si kompetencë Rregullatorit. Ju në këtë moment nuk duhet ta kaloni aktin për shqyrtim, duhet të pushoni gjykimin dhe Komisioneri duhet ta shqyrtojë vetë përmbajtjen e aktit. E theksoj kemi kundërshtime për përmbajtjen, por duhet t'i shqyrtojmë në një organ kompetent për arsye se ky është një proces ligjor dhe ne duam që rruga ligjore të jetë e drejtë për një procedurë, pastaj themeli do të diskutohet në vijim, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Salianji, sigurisht që jemi ne që e vlerësojmë këtë, ky ishte mendimi juaj. Atëherë të nderuar kolegë duke qenë se dhe në mbledhjen e djeshme dhe sot vazhdon të diskutohet çështja e kompetencës. Mendoj se duhet mes nesh të bëjmë një vlerësim, lidhur me faktin nëse Komisioni Rregullator

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.03.2021*

është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektaktit të paraqitur. Kështu që unë do t'iu ftoja ndërmjet votës të paraqisni qëndrimin tuaj. Pra, ajo çfarë shtrohet tashmë a është kompetent Komisioni Rregullator, për të shqyrtuar dhe miratuar këtë projektakt? Kush mendon të nderuar anëtarë që ne jemi organi kompetent për të shqyrtuar dhe miratuar këtë projektakt? Atëherë pyetja e rradhës, që po votojmë kush mendon që nuk është kompetenca jonë për të shqyrtuar dhe miratuar këtë projektakt?

Kush është dakord?


Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Komisioni Rregullator në unanimitet vlerëson që nuk është organi kompetent për të miratuar projektaktin e paraqitur. Kështu që pas këtij momenti nuk mund të shqyrtojmë projektaktin. Do të ftoja kolegun Çakaj që kërkoi të trajtonte një çështje jashtë rendit të ditës.

Z. M. Çakaj: Faleminderit e nderuar. Atëherë risjell në vëmendjen edhe të Komisionit Rregullator, por posaçërisht Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nenin 91 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon kryesisht pika 1, "Ndalimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore". Neni 91, pika 1, më lejon ta lexoj përpara jush për kujtesë edhe të të gjithëve, parashikon që "me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje, burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor apo çdo lloj enti tjetër kur shteti zotëron kapitale apo kuota, ose dhe emëron shumicën e organit mbikqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësie". Do të thotë që nuk mund., me fjalë të thjeshta dhe për publikun, avantazhin që ka shteti me burime shtetërore, nuk mund ta vendosin në dispozicion qoftë të një kandidati apo një partie politike. Çfarë ka ndodhur? Prej

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.03.2021*

disa ditësh siç jemi të gjithë koshient nga media, ka filluar një proces, një fakt i shumëpritur. Vaksinimi për të gjithë Shqipërinë dhe për shqiptarët, mund të ishte dhe më shpejt. Megjithatë kjo nuk duhet t'i japë avantazhe apo disavantazhe asnjë subjekti politik. Në aktin normativ nr.9 dhe nr.10, parashikohet miratimi i marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe një kompanie turke për importin e vaksinave të prodhuara në Kinë. Dua të theksoj se kjo kontratë është lidhur nga Kryeministri Shqiptar dhe nga Qeveria Shqiptare, posaçërisht për titullin e posaçëm që ka Kryeministri nuk është lidhur nga Kryetari i Partisë Socialiste, nuk është lidhur as nga Kryetari i Bashkisë Tiranë.

Kështu që, unë ftoj Komisionerin, në respekt edhe të vendimit nr.9 për veprimtaritë e ndaluara, të miratuar nga Komisioni Rregullator, që në mënyrë të menjëhershme të marrë masa. Të ndalojë propagandën dhe të ndalojë përdorimin e burimeve publike në mbështetje të një subjekti zgjedhor. Pse është burim publik? Në aktin normativ nr.9, të miratuar në datën 24-25 mars parashikohet që efektet financiare të kësaj marrëveshje (se kontrata është sekret), do të mbulohen nga Buxheti i Shtetit, pra nga Shqiptarët, nga takspaguesit shqiptarë. Më fal, po çfarë merite ka Kryetari i PS-së apo Kryetari i Bashkisë së Tiranës, që populli shqiptar paguan dhe po blen vakcina, të shpëtojë jetë njerëzish, pavarësisht se është e ndaluar kjo gjë? Për të përfituar avantazhet elektorale dhe në spotet, qoftë edhe Facebook, pavarësisht se Kodi Zgjedhor nuk e parashikon shprehimisht, shohim veprimtari jo vetëm të ndaluar, por mund të them është e paparë dhe e padëgjuar ndonjëherë në historinë, të paktën për një vit e gjysëm. Kush vend botëror zhvillon zgjedhje, është e paparë dhe e pa dëgjuar që të miksosh spotin elektorale të një subjekti zgjedhor me vaksinën. Kjo është e tmerrshme për shqiptarët, kjo duhet të ndërpritet urgjentisht! Ftoj Komisionerin që të ndërmarrë një hetim të plotë, të thelluar, të menjëhershëm dhe kjo duhet të ndërpritet. Faleminderit, kaq kisha.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.03.2021*

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Çakaj. I nderuar Komisioner, keni diçka në lidhje me këtë?

Z. I. Celibashi: Jo! Nuk kam asgjë për të thënë në lidhje me këtë çështje. Mbajta shënimet, ato çfarë tha kolegu i nderuar në lidhje me këtë çështje dhe në përputhje me parashikimet e kodit do t'a vlerësojmë dhe do të procedojmë në lidhje me këtë kërkim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, atëherë të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator, të nderuar pjesëmarrës meqenëse nuk kemi çështje të tjera për të shqyrtuar në rendin e ditës, e deklaroj të mbyllur mbledhjen e Komisionit Rregullator, natën e mirë!

Vendimi nr.12

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

